Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/111
Datë: 16.02.2018

Në mbështetje të neneve 15, pika 2, dhe nenit 17, pikat 1.5, 1.6 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, dhe 18, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 06.02.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuara nga ofruesi i AAP në zyrën e AKK, ku përfshihen aplikacioni për validim dhe akreditim, raporti i vetëvlerësimit dhe dëshmitë e kërkuara, zyra e AKK konsideron se janë plotësuar kushtet për miratim të aplikacionit për akreditim për institucionin Qendra e Bukurisë "Camellias" Sh.P.K. për kualifikimin Manikyrist/e.

2. Në bazë të këtyre dëshmive të dorëzuara AKK i rekomandon Këshillit Drejtues të AKK miratimin e këtyre aplikacioneve dhe të lejojë që AKK të vazhdojë me procesin sipas legjislacionit në fuqi.

Kryetari i KD së AKK-së
Bedri Xhafa